

## Abstrakt

Përparësitë e masave edukative ndaj të miturve kanë ndikuar që shtetet t'i përfshijnë këto masa në legjislacionet e tyre. Edhe Kosova ka treguar seriozitet në këtë drejtim duke i përfshirë këto masa në kuadër të Kodit të Drejtësisë për të mitur. Andaj qëllimi i këtij hulumtimi është analizimi i legjislacionit kosovar lidhur me masat edukative përmirësuese ndaj të miturve si dhe zbatimin e tyre në praktikë. Për realizimin e këtij hulumtimi është analizuar legjislacioni kosovar për të mitur si dhe zbatimin e tij në praktikën e Gjykatës Themelore në Prizren, përkatësisht shqiptimin e masave edukative nga kjo gjykatë gjatë viteve 2018-2022. Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se Kosova në vitin 2010 ka miratuar Kodin e Drejtësisë për të mitur i cili i përcakton disa lloje të masave edukative si: masat edukative përmirësuese, masat e mbikqyrjes së shtuar dhe masat institucionale. Poashtu me këtë Kod janë përcaktuar edhe mekanizmat për zbatimin e këtyre masave. Ndër këta mekanizma është edhe Gjykata Themelore në Prizren, e cila bazuar në analizimin e të dhënave statistikore gjatë periudhës kohore 2018-2022 ka shqiptuar gjithsej 431 masa edukative përmirësuese. Rezultatet e këtij hulumtimi poashtu tregojnë se 65,7% e veprave penale janë kryer nga grupmosha 17-18 vjeçare, kurse 95,6% e këtyre veprave penale janë kryer nga të miturit meshkuj. Veprat penale në të cilat kanë qenë të përfshirë këta të mitur janë: vjedhja e rëndë, lëndimi i lehtë trupor, vjedhja, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, pjesëmarrja në rrahje, ndërsa veprat tjera me një numër më të vogël.

***Fjalët kyçe:** I mitur, legjislacioni për të mitur, masat edukative përmirësuese, analizat statistikore*

## **Abstract**

The advantages of educational measures towards minors have influenced the states to include these measures in their legislations. Even Kosovo has shown seriousness in this direction by including these measures within the Juvenile Justice Code. Therefore, the purpose of this research is to analyze the Kosovo's legislation regarding remedial educational measures towards minors, as well as their implementation in practice. For the realization of this research, the Kosovo's legislation for minors and its implementation in the practice of the Basic Court in Prizren, namely the pronouncement of educational measures by this court during the years 2018-2022, have been analyzed. The results of this research show that Kosovo in 2010 adopted the Juvenile Justice Code which defines several types of educational measures such as: remedial educational measures, measures of increased supervision and institutional measures. Also with this Code, the mechanisms for the implementation of these measures are defined. Among these mechanisms is the Basic Court in Prizren, which, based on the analysis of statistical data during the period 2018-2022, has pronounced a total of 431 remedial educational measures. The results of this research also show that 65.7% of criminal offenses were committed by 17-18 year olds, while 95.6% of these criminal offenses were committed by male minors. The criminal offenses in which these minors have been involved are: serious theft, minor bodily injury, theft, unauthorized ownership, control or possession of weapons, participation in beatings, while other offenses with a smaller number.

**Key words:** Minor, Juvenile legislation, educational measures for minors, statistical analysis.